



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PAKR.nr.534/21

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Afërdita Bytyçi - kryetare, Xhevdet Abazi dhe Tonka Berishaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.M. nga fsh. ..., Komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 3 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit N.M., av. Arsim Vranovci, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore - DKR në Gjilan, PKR.nr.74/21 të datës 01.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK-së, më datë 21.01.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit N.M., ndërsa, aktgjykimi i Gjykatës Themelore - DKR në Gjilan, PKR.nr.74/21 i datës 01.11.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore - DKR në Gjilan, me aktgjykimin PKR.nr.74/21 datë 01.11.2021, e ka shpallur fajtor të akuzuarin N.M., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 3 të KPRK-së, dhe për këtë vepër penale e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 25 (njëzet e pesë) vjet, në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 25.07.2020 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimet, dënim ky i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarin N.M. e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100 (njëqind) €, si dhe shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar E.R., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në procedurë kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit N.M., av. Arsim Vranovci, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, vendimit për dënim dhe vendimit për shpenzimet procedurale, me propozim që ankesa të aprovohet, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK-së, për të cilën njoftoi Prokurorinë e Apelit, të dëmtuarit, të akuzuarin dhe mbrojtësin e të akuzuarit. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm i akuzuari N.M. dhe mbrojtësi i tij av. Arsim Vranovci dhe përfaqësuesja e Qendrës për Punë Sociale, Kimete Kryeziu, ndërsa, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt nuk prezantuan Prokurori i Apelit e as i dëmtuari E.R.. Në seancën e kolegjit mbrojtësi i të akuzuarit N.M., av. Arsim Vranovci, pasi më parë sqaroi disa nga pretendimet ankimore ngeli në tërësi pranë pretendimeve si në ankesë, të cilin e përkrahu edhe i akuzuari N.M..

Prokuroria e Apelit, me parashtresën PPA/I.nr.519/21 datë 21.12.2021, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit N.M. av. Arsim Vranovci, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore DKR - Gjilan, PKR.nr.74/21 i datës 01.11.2021, ndërsa, aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penale-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e kësaj gjykate.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.M., av. Arsim Vranovci, tek bazat ankimore të ankesës nuk e ka cekur shprehimisht bazën ankimore shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, mirëpo, nga përmbajtja e arsytimit të ankesës rezulton se aktgjykimi i ankimuar kundërshtohet edhe për këtë bazë ankimore, duke pretenduar kështu, se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyerat e aktgjykimit, në të nuk janë paraqitur arsyeza lidhur me faktet vendimtare edhe ato pak arsyeza që janë paraqitur janë në kundërthënie të plotë ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave në lëndë. Gjithherë, sipas pretendimeve ankimore, aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par. 12 të KPPK-së, shkelje këto të cilat konsistojnë me faktin se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, pastaj, i mungojnë arsyet për faktet vendimtare, gjegjësisht, ato që janë paraqitur kanë kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e tij dhe atë sidomos, përkitazi me përmbajtjen e deklaratave të dëshmitarëve dhe shkresave tjera të çështjes si dhe përpilimi i tij nuk është bërë konform dispozitave të nenit 370 të KPPK-së, shkelje këto të gjitha të cilat aktgjykimin e ankimuar e bëjnë të paligjshëm. Më tutje, në ankesë pretendohet se gjykata e shkallës së parë, nuk ka marr fare parasysh faktin e pranimin të fajit nga i akuzuari, mirëpo, vetëm përkitazi me kryerjen e veprës penale të vrasjes nën ndikimin e tronditjes së fortë psikike e jo me dashje, e duke mos marr kështu, parasysh mosmarrëveshjet në mes kryesit të veprës penale dhe tani të ndjerës, të cilat i kanë paraprirë konfliktit, e më pas edhe kryerjes së veprës penale. Prandaj, nuk është marr fare parasysh fakti se i akuzuari edhe pse e ka pranuar

veprën penale që i vihet në barrë, po ashtu, ka deklaruar se këtë e ka bërë pasi më parë kishte dalë nga kontrolli psikik dhe atë për shkak se tri herë radhazi ka qenë i goditur nga e ndjera, gjë që, vërtetohet edhe nga përshkrimi i procesverbalit të vendit të ngjarjes, pastaj, po ashtu, ka edhe faktorë tjerë të cilët kanë mundur të ndikojnë në aftësinë e zvogëluar mendore të akuzuarit dhe atë sidomos, gjendja ekonomike e cila përveç, që ka qenë e rënduar e njëjta e ka goditur më shumë të akuzuarin edhe si rezultat i masave të pandemisë, prandaj, janë të gjitha këto fakte që do duhej të merren parasysh, e që vërtetohen edhe nga deklarata e dëshmitarit R.M., i cili me të arritur në vendin e ngjarjes, kishte vërejtur se i akuzuari dukej i shqetësuar, nervoz dhe i mërzhitur, e që vërtetohet edhe nga fakti se i njëjti menjëherë pas kryerjes së veprës penale ishte i gatshëm ta lajmëronte policinë për ta njoftuar për rastin që ka ndodhur, prandaj, si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura si më lartë, propozon që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet e lartë cekura ankimore janë të pabazuara, ngase, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 par. 1 nën par. 12 e lidhur me dispozitat e nenit 370 par. 6 dhe 7 të KPPK-së, ngase, dispozitivi i aktgjykimi është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu, i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe gjithashtu edhe përpilimi i dispozitivit është bërë konform dispozitave të nenit 370 par. 4 e lidhur me nenin 365 të KPPK-së, ku janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat përkitazi me ngjarjen kritike, fakte dhe rrethana këto nga të cilat plotësohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par.3 të KPRK-së, për të cilën i akuzuari N.M. edhe është shpallur fajtor. Po ashtu, në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, përveç, që janë përshkruar të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarit, përkitazi me mënyrën se si është kryer vepra penale në fjalë, po ashtu, janë përshkruar edhe veprimet inkriminuese që përbëjnë formën cilësuese të veprës penale të vrasjes, pra, bëhet fjalë për vrasje të rëndë të kryer ndaj anëtarit të familjes, pra, bashkëshortes së të akuzuarit, e pastaj, janë përshkruar edhe veprimet inkriminuese të akuzuarit të ndërmarra në momentin kritik të kryerjes së veprës penale, por, edhe veprimet tjera të akuzuarit, por, edhe të tani të ndjerës S.M., e që edhe i kanë paraprirë kryerjes së veprës penale, e që në bazë të veprimeve në fjalë, rezulton se bëhet fjalë për vepër penale të vrasjes së rëndë të kryer me dashje direkte e jo vepër penale të vrasjes të kryer nën ndikimin e afektit mendor sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, që do të thotë se edhe në këtë drejtim dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar përfshin të gjitha veprimet inkriminuese që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 3 të KPRK-së. Për faktet dhe rrethanat në fjalë edhe në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, po ashtu, janë dhënë arsyerat e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penale-juridike, duke vepruar kështu, pra, konform dispozitave të nenit 370 par. 6 të KPPK-së, ku, gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsyerat për çdo pikë të aktgjykimit dhe atë si ato faktike dhe juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë, sidomos, ku në dispozitiv ka përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat që kanë mbështetje, përveç, në provat materiale në shkresat e lëndës edhe në deklaratat e të akuzuarit N.M., por, edhe dëshmitarëve të cilët edhe pse anëtar të familjes M., të njëjtit-

pra, dëshmitarët B. M., R.M., E. M. dhe F. M., kanë sqaruar në detaje raportet në mes të akuzuarit dhe tani të ndjerës, duke përshkruar në detaje se si i akuzuari N.M. dhe tani e ndjera S.M., nuk i kanë treguar asnjërit nga familjarët për raportet e tyre, por, që të gjithë vërtetojnë se të njëjtit kanë jetuar në kushte të rënda ekonomike, ku shtëpinë ua ka ndërtuar shoqata bamirëse, ndërsa, dëshmitarët tjerë e që janë familjar të tani të ndjerës edhe pse shprehimisht nuk e pranojnë vërtetohet se raportet në mes tyre nuk kanë qenë aq të mira, sidomos, kur

deklarojnë se të njëjtën-pra, të ndjerën në shumicën e rasteve e ka sjellë në familjen e saj-pra, tek prindërit vëllai i të akuzuarit-pra, kunati e jo bashkëshorti i sajë, mirëpo, pra, gjykata e shkallës së parë, përkitazi me raportet e tyre familjare kanë marr për bazë sidomos, edhe procedurat gjyqësore që janë zhvilluar kundër të akuzuarit, e që vërtetojnë se i akuzuari N.M., gjithëherë, në familjen e tij ka qenë i dhunshëm dhe se ngjarja ditën kritike nuk ka ndodhur për shkak të sjelljeve jo të mira të tani të ndjerës, por, pikërisht, për shkak të sjelljeve të akuzuarit, e që ditën kritike edhe ka ardhur edhe nga privimi nga jeta i tani të ndjerës, e që pa mëdyshje është vërtetuar se ditën kritike i akuzuari N.M., ka ndërmarrë veprime konkrete inkriminuese në drejtim të kryerjes së veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtor. Natyrisht, gjykata e shkallës së parë, një konkludim të tillë e ka aprovuar, pasi më parë ka bërë vlerësimin e provave në pajtim me dispozitat e nenit 361 par. 2, kurse, për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par.7 të KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesash i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore, pra, ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Po ashtu, përveç, në dispozitiv që ka përfshirë të gjitha veprimet inkriminuese të akuzuarit që kanë të bëjnë me marrëdhëniet jo të mira të akuzuarit me tani të ndjerën S.M., edhe në arsyetim po, për faktet dhe rrethanat në fjalë, ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe atë duke u mbështetur, përveç, në deklaratat e dëshmitarëve, pastaj, vetë të akuzuarit, ka marr parasysht edhe provat materiale, e sidomos, aktgjykimet e plotfuqishme të gjykatave, ku vërtetohet se i akuzuari ka qenë i dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm dhe atë pikërisht për shkak të dhunës në familje që do të thotë se i njëjti edhe para ditës kritike ishte sjellë në mënyrë të dhunshme me tani të ndjerën-ish bashkëshorten e tij S.M., që do të thotë se me të drejtë ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, se bëhet fjalë për vrasje të rëndë, e të kryer me dashje direkte e jo sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, pra, vrasje e kryer nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, për çka, pra, në këtë drejtim edhe në arsyetim, përkitazi me atë se përse i akuzuari nuk ka vepruar në gjendje të afektit mendor, janë dhënë arsye të mjaftueshme e konkrete, por, edhe të bazuara në prova dhe shkresa të tjera të lëndës, prandaj, sa i përket edhe kualifikimit të veprës penale nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se i akuzuari N.M., nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Prandaj, përveç, që qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme as një fakt nuk ka ngelur i dyshimtë ose i pavërtetuar dhe përveç, që janë vërtetuar drejtë ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë. Kështu, në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe po ashtu, edhe për mënyrën se si ka ardhur deri te kryerja e veprës penale nga i akuzuari, ku përkitazi, me faktet dhe rrethanat në fjale, se pari ka marr parasysht deklaratat e vetë të akuzuarit N.M., i cili në mbrojtjen e tij nuk e ka mohuar kryerjen e veprës penale në drejtim të bashkëshortes së tij, mirëpo, duke u arsyetuar se këtë e ka bërë si pasojë e provokimeve që ia ka bërë tani e ndjera S.M.-bashkëshortja e tij, pretendime këto të cilat me të drejtë gjykata e shkallës së parë, nuk i ka aprovuar, ngase, të njëjtat nuk kanë mbështetje në asnjërën nga provat materiale në shkresa të lëndës, e as në deklaratat e dëshmitarëve, ku të gjithë këta, pra, dëshmitarët e familjes së të akuzuarit dhe dëshmitarët e familjes së tani të ndjerës S.M. nuk kanë deklaruar se tani e ndjera të ketë pasur sjellje jo të mira ndaj të akuzuarit, e që përkitazi me këtë nuk kanë deklaruar se as për ditën kritike, e që të njëjtat fakte dhe rrethana-pra, se tani e ndjera nuk është sjellë mirë me të akuzuarin e që më pastaj, i akuzuari ta ketë privuar nga jeta, faktet dhe rrethanat në fjalë nuk vërtetohen as nga vetë deklarata e të akuzuarit, ku pikërisht nga deklarata e tij, vërtetohet se ditën kritike pasi i ka kërkuar tani të ndjerës S.M.-pra, bashkëshortes së tij që të zgjohet nga gjumi dhe për arsye të panjohura e njëjta nuk zgjohet, për çka, i akuzuari pastaj, ka vazhduar me punët e tij në oborrin e shtëpisë, ku, e njëjta-pra, bashkëshortja, pastaj, është zgjuar rreth orës 7,20 min. dhe më pastaj, kuptohet sipas deklaratës së të akuzuarit, e njëjta, e ka fyer me fjalët, se përse e ka zgjuar nga gjumi, gjë

që sipas të akuzuarit, kjo ka zgjatur deri rreth orës 10,00 min, ku pastaj, kanë ngrënë mëngjes së bashku dhe aty prapë kanë filluar fyerjet në mes tyre, ku tani e ndjera e ka kërcënuar se do ta lajmërojë policinë, për çka, pastaj, i akuzuari ka dalë në oborr të shtëpisë dhe ka marrë një shufër metalike dhe pasi ka hyrë sërish brenda në shtëpi, tani e ndjera në ndërkohë ishte fshehur, ku i akuzuari pasi e kërkon dhe e gjen të fshehur, menjëherë e ka goditur me shufër metalike, e që, sipas tij tani më nuk e din se çka ka ndodhur dhe se sa herë e ka goditur, mirëpo, tani e ndjera ka mbetur e vdekur në vendin e ngjarjes, kuptohet, si pasojë e goditjeve në fjalë, që do të thotë se sipas një deklaratë të tillë nuk mund të flitet për vrasje në gjendje të afektit mendor, ngase, sikur që u konstatua më lartë, nga vetë mbrojtja e të akuzuarit vërtetohet se nuk bëhet fjalë për vrasje të kryer në afekt, por, për vrasje të kryer me dashje direkte, ngase, i akuzuari pasi më parë kishte pasur konflikt verbal me tani të ndjerën, ka dalë jashtë, ka marr shufrën metalike dhe është futur sërish në shtëpi dhe e ka kërkuar tani të ndjerën derisa e ka gjetur, ku më pas edhe e ka goditur me shufër metalike, duke shkaktuar kështu lëndime trupore, që si pasojë tani e ndjera ka ndërruar jetë në vendin e ngjarjes, e që, pra, gjithëherë, sipas deklaratës së vetë të akuzuarit, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e kaluar nga fillimi i konfliktit verbal e deri tek goditja e tani të ndjerës nga i akuzuari, pra, diku rreth 3 orë ka zgjatur biseda e tyre-pra, grindja në mes tyre, e sidomos, edhe momenti kritik, kur i akuzuari del në oborrin e shtëpisë e merr shufrën e metalit dhe kthehet sërish brenda në shtëpi, pra, me qëllim që ta godas tani të ndjerën, por, të njëjtën nuk e gjen, pasi ishte fshehur, ku, pastaj, fillon ta kërkojë nëpër dhomë dhe pasi e gjen edhe e godet me shufër metalik, atëherë, pa dyshim që nuk mund të flitet për vrasje nën ndikimin e afektit mendor, sidomos, kur merret parasysh edhe fakti se tani e ndjera nuk kishte ndërmarrë kurrfarë veprimi fizik apo edhe verbal që do të mund ta provokonte të akuzuarin apo që të njëjtin ta sjellte në gjendje të tronditjes së fortë mendore, kuptohet pa fajin e të akuzuarit prandaj, konkludimi i gjykatës së shkallës së parë, se i akuzuari me dashje direkte e ka privuar nga jeta tani të ndjerën S.M., duke kryer kështu veprë penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 3 të KPRK-së, janë të drejta, të arsyeshme dhe të bazuara në prova dhe shkresa tjera të lëndës. Po ashtu, përveç, deklaratës së të akuzuarit përkitazi me mënyrën se si e ka kryer veprën penale të vrasjes i akuzuari, gjykata e shkallës së parë, ka marr parasysh edhe ekspertizën psikiatrike ku është konstatuar se i akuzuari në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendje të aftë mendore, pra, i njëjti përveç, që ka kuptuar pasojat e veprimit të tij, po ashtu, ka qenë në gjendje edhe t'i kontrollojë veprimet e tij, prandaj, edhe në këtë drejtim nuk ka pasur kurrfarë ngecje në aspektin e zhvillimit mendor të akuzuarit, ku përkitazi me këtë konstatim në ekspertizë është marr parasysh edhe e kaluara e tij shëndetësore, ku pra, nuk është konstatuar se i njëjti ka lënguar nga ndonjë sëmundje mendore të çfarëdo lloji, për çka, edhe me të drejtë edhe është konstatuar se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, por, i njëjti ka vepruar me dashje dhe atë dashje direkte, pra, për ta privuar nga jeta tani të ndjerën S.M.-pra, bashkëshorten e tij. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e saj, ka pasur parasysh edhe propozimet e palëve të refuzuara dhe atë sidomos, përkitazi me nxjerrjen e ekspertizës tjetër të psikiatrisë, ku me të drejtë, gjykata e shkallës së parë, e ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të akuzuarit për ekspertizë tjetër, ngase, sikur që rezulton edhe nga vetë përmbajtja e ekspertizës psikiatrike, ku është konstatuar se i akuzuari ka qenë i aftë në aspektin mendor, përkitazi, me këtë është marr parasysh edhe fakti se i njëjti-pra, i akuzuari deri sot nuk ka pasur kurrfarë problemesh në aspektin shëndetësor, prandaj, edhe nuk ka pasur arsye të argumente që të mos i besohet një ekspertizë të tillë, për çka, edhe është refuzuar propozimi i mbrojtjes së të akuzuarit për ekspertizë tjetër, duke e vlerësuar propozimin në fjalë si të pabazë dhe të pa argumentuar, sidomos, kur mbrojtësi i të akuzuarit nuk ka arritur që të paraqes as edhe një provë të vetme se i akuzuari ndonjëherë gjatë jetës së tij të ketë pasur probleme shëndetësore, përkitazi me shëndetin e tim mental.

Prandaj, në bazë të cekurave si më lartë, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i

ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 e par. 1 nën par. 12 e lidhur me nenin 370 par. 6 dhe 7 të KPPK-së, sikur që pretendohet në ankesë.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal si dhe gjetjet e kësaj gjykate.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike me ankesë në esencë vetëm janë përsëritur pretendimet e njëjta ankimore të cekura tek baza ankimore shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, ku, në esencë, kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, e sidomos, kur merret parasysh se në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se vepra penale është kryer pa dashjen e të akuzuarit, por, krejt kjo ka ndodhur si pasojë e kushteve të rënda të jetesës së të akuzuarit por, edhe veprimeve konkrete provokuese që i ka ndërmarrë tani e ndjera S.M., ku pastaj, i akuzuari pa dashjen e tij e nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore edhe e ka kryer veprën penale në fjalë, prandaj, me vetë faktin gjykata e shkallës së parë, e ka shpallë fajtor të akuzuarin, si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ka bërë edhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit N.M., për çka, edhe propozon që të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë, ngase, në këtë çështje penalo-juridike gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pakontestueshme ka vërtetuar se ditën kritike në shtëpinë e tyre të përbashkët pas një konflikti më parë verbal në mes tyre, i akuzuari N.M., e ka goditur tani të ndjerën S.M. me një shufër metalike në pjesë të ndryshme të trupit, të përshkruara më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ku si pasojë e goditjeve, gjegjësisht, lëndimeve të marra tani e ndjera S.M. ka mbetur e vdekur në vendin e ngjarjes. Faktet dhe rrethanat në fjalë, përveç, nga deklaratat e vetë të akuzuarit janë vërtetuar edhe nga provat materiale në shkresa të lëndës, si raporti nga vendi i ngjarjes, raporti i autopsisë, skica e vendit të ngjarjes, foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë, prova këto nga të cilat është vërtetuar se tani e ndjera si pasojë e goditjeve me mjet të fortë ka mbetur e vdekur në vendin e ngjarjes.

Ndërsa, përkitazi me faktet kontestuese, se i akuzuari a e privoi nga jeta tani të ndjerën S.M.-pra, bashkëshorten e tij me dashje direkte apo këtë e ka bërë nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, përkitazi me faktet dhe rrethanat në fjalë, përveç, deklaratës së të akuzuarit, i cili në detaje e ka shpjeguar ngjarjen se si ka ardhur deri tek privimi nga jeta i bashkëshortes së tij-tani të ndjerës S.M., ka marr parasysh edhe ekspertizën e psikiatrisë, nga e cila është vërtetuar gjendja e tij mendore, pra, të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, ku nga ekspertiza në fjalë është konstatuar se i akuzuari në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë në aspektin mendor dhe i njëjti përveç, që ka qenë në gjendje të kuptojë pasojat e veprimit të tij, po ashtu, ka pasur aftësi edhe të kontrollit të veprimeve të tij, e duke pasur parasysh edhe mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe atë sidomos, faktin se tani e ndjera S.M., nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të vetëm në drejtim të provokimit të akuzuarit, atëherë, edhe ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, se bëhet fjalë për veprë penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 3 të KPRK-së, e jo vrasje e kryer nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit. Një konkludim të tillë gjykata e shkallës së parë, e ka aprovuar duke marr parasysh së pari vetë deklaratën e të akuzuarit, i cili deklaroi se tani të ndjerën e ka goditur me shufër metalike në pjesë të ndryshme të trupit dhe atë pas një konflikti të mëparshëm verbal, me arsyetim se pasi që tani e ndjera nuk ishte zgjuar nga gjumi me kohë aty edhe ka filluar grindja në mes tyre, e

që sipas vetë deklaratës së të akuzuarit kjo ka zgjatur përafërsisht nga ora 7,30 e mëngjesit deri në ora 10,00. ku prapë grindja ka vazhduar kur i akuzuari ka dalë nga shtëpia dhe në oborrin e shtëpisë e ka marrë një shufër të metalit dhe është kthyer sërish brenda në shtëpi për ta sulmuar tani të ndjerën, mirëpo, pasi që e njëjta ishte fshehur i akuzuari ka filluar ta kërkojë me shufër në dorë derisa e ka gjetur dhe pastaj, të njëjtën e ka goditur me shufër metalit në pjesë të ndryshme të trupit, duke i shkaktuar kështu lëndime të rënda trupore, si pasojë e të cilave edhe ka mbetur e vdekur në vendin e ngjarjes, fakte këto dhe rrethana, që gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe me prova materiale në shkresa të lëndës, kuptohet, përkitazi me lëndimet e shkaktuara tek tani e ndjera, pasojën e tyre, pra, lidhjen kauzale me vdekjen e tani të ndjerës dhe goditjet në fjalë, e që pastaj, duke marrë parasysh sidomos, kohën që ka kaluar nga momenti kur kanë filluar grindjet në mes tyre e deri tek veprimi i të akuzuarit, pra, goditja me shufër të metalit tani të ndjerën dhe atë pasi del më parë në oborrin e shtëpisë e merr shufrën metalike, e pastaj, sërish futet në shtëpi, ku në fillim nuk e gjen tani të ndjerën, e cila ishte fshehur, mirëpo, i akuzuari vazhdon ta kërkojë derisa e gjen dhe e godet me shufrën në fjalë, që do të thotë se në momentin kritik, tani e ndjera S.M., nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të vetëm në drejtim të sulmit, keqtrajtimit apo fyerjes së të akuzuarit e që do ta sjellte të akuzuarin në gjendje të tronditjes së fortë mendore, e që pastaj, i akuzuari të ketë kryer veprën penale nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, për çka, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë edhe ka konstatuar se në rastin konkret në bazë të gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, pa dyshim që vërtetohet se i akuzuari me dashje direkte e ka privuar nga jeta tani të ndjerën S.M., e jo nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura, si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari N.M., është kryerësi i veprës penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1. 3 të KPRK-së, është i drejtë dhe se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor dhe është gjykuar, prandaj, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, sikur që pretendon mbrojtja e të akuzuarit, kur i akuzuari N.M., është shpallur fajtor dhe është gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me vendimin për dënim dhe gjetjet e gjykatës.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit nuk janë të bazuara.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit N.M., av. Arsim Vranovci, përkitazi me këtë bazë ankimore pretendohet se gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim shumë të rëndë, kur merret parasysh, sidomos, mënyra se si ka ardhur deri tek vrasja, pastaj, nuk është marrë fare parasysh se i akuzuari e ka pranuar veprën penale në fjalë, në kuptim të kryerjes së vrasjes nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, pra, jo me dashje dhe se në kryerjen e veprës penale kanë ndikuar edhe faktorët tjerë, e sidomos, gjendja e rëndë ekonomike e të akuzuarit, por, edhe pandemia, prandaj, gjykata ka vlerësuar gabimisht edhe dispozitat e nenit 41 par. 1, nenit 69 par. 1, 2 e 3 të KPRK-së, ngase, nuk ka pasur parasysh sidomos, qëllimin e dënimit, por, edhe rrethanat lehtësuese sikur që është pranimi i kryerjes së veprës penale, atëherë, rezulton se dënimi i caktuar është në shpërputhje të plotë me veprën penale të kryer pa dashje dhe si rezultat i të gjitha këtyre të akuzuarit i ka shqiptuar dënim të ashpër, për çka, propozon anulimin e aktgjykimit të ankimuar dhe kthimin e çështjes në rivendosje.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së

dënimit siç parashih dispozita e nenit 73 të KPRK-së. Pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit nuk janë të bazuara, ngase, përveç, parafrazimit të dispozitave që parashohin rrethanat rënduese dhe lehtësuese, sipas dispozitave të KPK-së, nuk ceket asnjë rrethanë konkrete lehtësuese e që do të ndikonte në zbutjen e dënimit, por, vetëm pretendohet se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale të vrasjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, por, bëhet fjalë për vrasje të kryer pa dashjen e të akuzuarit dhe se këtë e ka bërë nën ndikimin e tronditjes së fortë mendore, e duke potencuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale të vrasjes, por, jo me kualifikimin juridik si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, prandaj, edhe konsideron se dënimi i shqiptuar është i ashpër, mirëpo, një pretendim i tillë nuk qëndron, ngase, përkitazi me faktet se përse, i akuzuari është shpallur fajtor dhe është gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, përkitazi me këtë arsye u dhanë si më lartë, tek bazat tjera ankimore, ndërsa, kur është fjala për vendimin për dënim, pretendimet e mbrojtjes janë të pabazuara, ngase, i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale të vrasjes, sikur që edhe është shpallur fajtor, kurse, përveç, rrethanave të cekura lehtësuese në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, në ankesë nuk është cekur as edhe një rrethanë e vetme tjetër lehtësuese që do të ndikonte në zbutjen e dënimit të akuzuarit, sidomos, kur dihet se për veprën penale në fjalë është paraparë maksimumi i dënimit edhe me dënim me burgim të përjetshëm.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e konstatuara në aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, mënyrën se si është zhvilluar ngjarja kritike, kontributin e veprimtarisë inkriminuese të akuzuarit, por, edhe vendin e kryerjes së veprës penale, pra, në shtëpinë e tyre të përbashkët, pastaj, se kjo ka ndodhur pranë fëmijëve të mitur, mjeti i përdorur për kryerjen e veprës penale, pra, bëhet fjalë për shufër të metalit, por, edhe vendin ku është goditur tani e ndjera-pra, në pjesët më të ndjeshme të trupit dhe se edhe përkundër rrëzimit të viktimës për toke, pra, edhe pse ka mbetur e shtrirë për toke i akuzuari edhe më tutje ka vazhduar me goditjet në fjalë, pra, ka treguar këmbëngulësinë në kryerjen e veprës penale, e me këtë edhe sjellja e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, ku i njëjti fare nuk tenton t'i ofrojë ndihmë mjekësore viktimës, por edhe faktin se përveç, që ka mbetur dy fëmijë të mitur pa nënë, njëkohësisht, nga kjo e drejtë është privuar edhe fëmia i porsalindur, pra, vetëm dy muajsh ka qenë kur është privuar nga jeta nëna e tij, atëherë, me të drejtë rezulton se dënimi të cilin i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit është i drejtë dhe i ligjshëm, pastaj, i njëjti është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës të kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, është në funksion të preventivës gjenerale dhe individuale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPK-së.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit N.M., av. Arsim Vranovci, tek bazat ankimore vendimi për dënim, njëkohësisht është cekur edhe vendimi për shpenzimet procedurale, mirëpo, nga arsyetimi i ankesës rezulton se nuk kundërshtohet baza ligjore por as lartësia e shpenzimeve procedurale, por, kërkohet që i akuzuari të lirohet nga kompensimi i shpenzimeve procedurale për shkak të gjendjes së tij ekonomike, për çka, kjo gjykatë pretendimet në fjalë nuk i mori parasysh pasi që me dispozitat e nenit 453 par. 4 të KPPK-së, rregullohet në detaje procedura se si i akuzuari mund të lirohet nga kompensimi i shpenzimeve të procedurës penale, gjë që, një gjë të tillë mund ta bëjë duke paraqitur kërkesë gjykatës së shkallës së parë, e më pastaj, pas vendosjes nga gjykata e shkallës së parë, atëherë, varësisht nga mënyra e vendosjes, i akuzuari mund t'i drejtohet me një ankesë Gjykatës së Apelit.

Nga sa u tha më lartë, e konform dispozitës së nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.534/2021, më 21.01.2022

Procesmbajtëse,
Leonita Lajqi

Anëtarët e kolegjit,

1.Xhevdet Abazi

2.Tonka Berishaj

Kryetare e kolegjit,
Afërdita Bytyçi